



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 24.02.2026

**MBLEDHJA Nr. 10,
Datë 26.02.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 26.02.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 10, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. në lidhje me marrjen e autorizimit të ERE-s për transferim (nëpërmjet marrëveshjes siguroese) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.
3. Mbi përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 345, datë 29.12.2025, “Mbi kërkesën e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “TONA ALB/6390”.
4. Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2026.
5. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrir AHMETI**